

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5853
E premte, 16 gusht 2019
çmimi 0.40 €

Përurohet aparatura e re në Klinikën e Kirurgjisë Torakale

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", TIME KADRIJAJ | FAQE 4-5

Gjykata Speciale do të dështojë

Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadriaj, e ka quajtur padrejtësi të madhe ballafaqimin e ish-ushtarëve të UÇK-së me Gjykatën Speciale. Ajo ka treguar se ende nuk e di se në çfarë cilësie do të paraqitet në këtë gjykatë, megjithatë ka thënë se do t'i përgjigjet pozitivisht çfarëdo ftese. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kadriaj ka deklaruar se kjo gjykatë do të dështojë meqë, sipas saj, nuk ka çfarë të thuhet dhe të dëshmohet përveç pastërtisë së luftës së UÇK-së. Kadriaj ka folur edhe për zhvillimet e fundit politike, me ç'rast ka theksuar se më 22 gusht Kuvendi do të shpërndahet dhe vendi do të shkojë në zgjedhje. Ajo ka deklaruar se AAK-ja do të jetë befasia e këtyre zgjedhjeve



Kosova e gatshme për dialog pa kushte

FAQE 3



Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, është shprehur pro vazhdimin të dialogut me Serbinë pa kushtëzime. Duke iu përgjigjur deklaratës së vendeve të Qunitit për rikthim të dialogut të Brukselit, ai ka thënë se dialogu Kosovë - Serbi duhet të jetë pa vonesa dhe pa kushte. Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli ka mirëpritur përpjekjet e ShBA-së, të Gjermanisë, të Britanisë së Madhe, të Francës dhe të Italisë për zhvillimin e dialogut, duke thënë se BE-ja fillimisht duhet t'ia ndalojë disa veprime Serbisë

Prishtina dhe Vushtrria, komunat më të suksesshme

FAQE 7



AKTUALE

INVESTIMET NË QENDRAT KORREKTUESE PARANDALUAN DUKURITË NEGATIVE F. 7



BERZH-I OFRON 25 MILIONË EURO KREDI PËR INVESTIME NË FERRONIKEL F. 8

MINISTRIA E ARSIMIT FILLON NDËRTIMIN E NJË ÇERDHEJE TË RE NË KLINË F. 7

EKONOMI



RRITEN KAPACITETET PRODHUESE VENDORE, POR EDHE ÇMIMET F. 9

PUNËTORËT E AEROPORTIT NGA E HËNA FILLOJNË GREVËN F. 8

SPORT

KËRKOHEM HAPËSIRË PËR SHTATOREN E VOKRIT DHE STATUJËN E KELMENDIT F. 18



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Republika e Kosovës - Vlada Kosovo - Government of Kosovo
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth & Sports

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Xhaçka në ceremoninë për presidenten e re të Komisionit Evropian

TIRANË, 15 GUSHT - Me ftesë të veçantë të ministres së re të Mbrojtjes së Gjermanisë Annegret Kramp-Karrenbauer, ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhaçka ka marrë pjesë të enjten në mbremje, në ceremoninë e përcjelljes së ministres së sapodorëhequr të Mbrojtjes të Gjermanisë Ursula von der Leyen, e cila u zgjodh presidente e Komisionit



Evropian. Në ceremoninë ushtarake me traditë 200-vjeçare, që u rezervohet personaliteteve më të spikatura të politikës do të marrin pjesë bashkëpunëtorët dhe miqtë më të afërt të ish-ministres Ursula von der Leyen. Vetëm pak javë përpara se të zgjidhej në detyrën më të lartë të Bashkimit Evropian, Ursula von der Leyen, në cilësinë e ministres

së Mbrojtjes, priti në një vizitë zyrtare në Berlin ministren Xhaçka. Në ceremoninë ku marrin pjesë personalitete nga e gjithë bota, do të jetë e pranishme edhe kancelarja Merkel, e cila do të mbajë fjalën e rastit. Ursula von der Leyen është e para grua që zgjidhet presidente e Komisionit Evropian dhe pritet ta marrë detyrën më 1 nëntor 2019.

Kallëzim penal ndaj 22 policëve për dëbimin e shtetasve turq

Inspektorati i Policisë së Kosovës ka dorëzuar në Prokurorinë Speciale kallëzime penale ndaj 22 zyrtarëve të Policisë së Kosovës në lidhje me dëbimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova para më shumë se një viti

PRISHTINË, 15 GUSHT - Prokuroria Speciale e Kosovës ka pranuar 22 kallëzime penale nga Inspektorati Policor i Kosovës ndaj 22 zyrtarëve të Policisë së Kosovës në lidhje me dëbimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova para më shumë se një viti. Ky rast njihet ndryshe edhe si rasti "Gylenistët".

"Ju njoftojmë se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka pranuar kallëzim penal nga IPK-ja ndaj 22 të pandehurve, ndërsa jemi duke intervistuar edhe të pandehur të tjerë në lidhje me këtë rast", ka thënë në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", Ekrem Lutfiu, zyrtar për media nga Prokurorinë e Shtetit. Kurse, Inspektorati i Policisë së Kosovës lidhur me kallëzimet penale që ka dorëzuar në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, nuk ka dhënë detaje se për çfarë profile të Policisë së Kosovës bëhet fjalë në këto kallëzime penale, por se në një përgjigje me shkrim sqaron se "Inspektorati lidhur me këtë rastin ka vepruar duke u bazuar në autorizimet ligjore dhe autorizimet nga Prokuroria Speciale e Republikës së

Kosovës".

"Inspektorati Policor i Kosovës, respektivisht hetuesit e Departamentit të Hetimeve, lidhur me rastin e dëbimit të shtetasve turq nga Republika e Kosovës për në Turqi, bazuar në autorizimet ligjore dhe autorizimet nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, kanë ndërmarrë veprime hetimore dhe pas këtyre veprimeve kanë dorëzuar edhe kallëzim penal ndaj 22 zyrtarëve të Policisë së Kosovës", thuhet pos tjerash në përgjigje.

Anëtari i Komisionit Hetimor Parlamentar në Kuvendin e Kosovës për dëbimin e gjashtë shtetasve turq, Sami Kurteshi, tha për "Radion Evropa e Lirë" se i gjithë procesi i lidhur me rastin e njohur si "Gylenistët" duhet të shkojë deri në fund dhe të zbardhet si rast.

Ai ka thënë se është e rëndësishme që mekanizmat e drejtësisë të merren seriozisht me rastin.

"Unë mendoj se ky nuk është proces që mund të lihet pa shkuar deri në fund. Ne kemi ligj, kemi Kushtetutë e kemi një Kod Penal dhe i kemi të gjitha normat



për aq sa janë dhe duhet të zbatohen deri në fund. Ky nuk ka qenë një veprim krejt i thjeshtë dhe ky rast duhet të shkojë deri në fund dhe nëse nuk shkon tash, duhet të shkojë pas një kohe, por kjo vepër nuk vjetrohët", tha Kurteshi.

Në mars të vitit 2018, me kërkesë të autoriteteve turke, autoritetet kosovare patën arrestuar dhe dëbuar për në Turqi gjashtë shtetas turq.

Për gjashtë shtetasit turq, Ankaraja dyshon se janë anëtarë të organizatës "Hizmet", të udhëheqësit fetar turk, Fetullah Gulen.

Këtë të fundit, autoritetet turke e fajësojnë për një përpjekje për

grusht-shtet në Turqi në vitin 2016. Dëbimi i tyre kishte nxitur reagime të ashpra nga shtetet perëndimore, por edhe vetë ish-kryeministri Ramush Haradinaj, që pati deklaruar se nuk ishte në dijeni të këtij operacioni.

Më 28 qershor të vitit 2018, Kuvendi i Kosovës themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar për ndriçimin e rastit të dëbimit nga Kosova të gjashtë shtetasve turq.

Komisioni Hetimor Parlamentar i Kuvendit të Kosovës, për rastin e dëbimit të shtetasve turq, ka identifikuar 31 shkelje ligjore gjatë procesit të arrestimit dhe dëbimit nga Kosova të 6 shtetasve turq.

Komisioni ka gjetur shkelje në secilën fazë, që nga revokimi i lejeve të qëndrimit për 6 shtetasit turq e deri te largimi i tyre nga Kosova.

Shkeljet më të mëdha, sipas udhëheqësve të këtij Komisioni, ishin bërë nga dy agjencitë kryesore të sigurisë në Kosovë, përkatësisht Agjencia e Kosovës për Inteligjencë dhe Policia e Kosovës.

Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, pas dëbimit të shtetasve turq, kishte pranuar dorëheqjet e ministrit të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj si dhe drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Driton Gashi.

Pjetri dorëhiqet nga Bashkia e Shkodrës

TIRANË, 15 GUSHT - Dorëhiqet nga marrja e detyrës si kryebashkiak i Shkodrës, Valdrin Pjetri. Në një reagim në Facebook, Pjetri deklaroi se ka vendosur që çështjen e akuzave për dënimin e tij në Itali ta sqarojë në rrugë ligjore, si qytetar dhe jo si zyrtar i institucioneve apo si përfaqësues i Partisë Socialiste.

"I ndërgjegjshëm përrëndësinë e

imazhit politik dhe i vendosur që këtë sqarim ligjor ta ndërmarr në pozitën e qytetarit të thjeshtë, pa iu bërë barrë askujt, vendos të dorëhiqem nga marrja e detyrës së kryetarit të Bashkisë Shkodër", deklaroi Valdrin Pjetri.

Në mesazhin e tij, Pjetri shprehet i bindur se çështja e dënimin të tij në Itali ka qenë keqkuptim. Ai jep një version tjetër të ngjarjes duke

u shprehur se bëhet fjalë për një "një ngjarje krejt banale e ndodhur në mes të shokëve të mi bashkëstudentë, në të cilën unë nuk kam asnjë faj e përgjegjësi e nuk i kisha kushtuar rëndësi, 17 vjet më parë në moshën 20-vjeçare, u nxor nga konteksti dhe rreth saj u ngritën akuzat e linçimeve përtej çdo skrupulli moral e njerëzor. Nuk e kisha

menduar kurë që një ditë do të gjendesha përballë akuzave të tilla. Dhe sado i bindur të jem në pafajësinë ligjore dhe pastërtinë morale të personit tim, me keqardhje ju rrefej se të tilla shpifje kanë shkaktuar dhimbje të mëdha te unë e familja ime dhe se unë kurrë nuk kam qenë pjesë e kësaj kategorie për të cilën sot akuzohem", tha Pjetri.



Institucionet e Kosovës i përgjigjen deklaratës së vendeve të Quintit

Kosova e gatshme për dialog pa kushte

Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, është shprehur pro vazhdimin të dialogut me Serbinë pa kushtëzime. Duke iu përgjigjur deklaratës së vendeve të Quintit për rikthim të dialogut të Brukselit, ai ka thënë se dialogu Kosovë - Serbi duhet të jetë pa vonesa dhe pa kushte. Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli ka mirëpritur përpjekjet e ShBA-së, të Gjermanisë, të Britanisë së Madhe, të Francës dhe të Italisë për zhvillimin e dialogut, duke thënë se BE-ja fillimisht duhet t'ia ndalojë disa veprime Serbisë

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 GUSHT - Institucionet e Kosovës janë shprehur të gatshme për vazhdimin e dialogut pa kushte me Serbinë. Dy ditë pasi vendet e Quintit i kërkuan Kosovës dhe Serbisë që t'i heqin të gjitha pengesat për vazhdimin e dialogut të Brukselit, kryeministri në dorëheqje i Kosovës, Ramush Haradinaj, është shprehur në favor të vazhdimin të dialogut me

Serbinë. Mirëpo, ai ka thënë se ky dialog duhet të jetë pa kushte. "Pajtohem për nevojën e normalizimit të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Qeveria ua ka paraqitur Quintit dhe BE-së draftin e marrëveshjes gjithëpërfshirëse që përfshin temat për njohje të dyanshme në kufijtë ekzistues. Ritheksoj se dialogu duhet të jetë pa vonesa dhe pa kushte. Tregun për njohjen", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e tij në "Twitter". Ky qëndrim i Haradinajt vjen dy

ditë pasi Qeveria e Francës, e Gjermanisë, e Italisë, e Mbretërisë së Bashkuar dhe e Shteteve të Bashkuara kërkuan nga Kosova dhe Serbia që në mënyrë urgjente t'i kthehen dialogut për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Përmes një deklaratë të përbashkët, vendet e Quintit kanë shprehur gatishmërinë e tyre për ta forcuar rolin në këtë proces duke kërkuar nga të dyja palët të shmangin veprime që do të pengonin një marrëveshje

përfundimtare e cila është e nevojshme për të dy vendet për të arritur integritet më të madh euroatlantik dhe përfitimet përcjellëse. "Ne jemi të gatshëm ta forcojmë rolin tonë në këtë proces në përkrahje të përfaqësuesit të lartë të BE-së, por mund ta bëjmë një gjë të tillë vetëm kur ju të jepni shenja të gatishmërisë për kompromis, për heqjen e pengesave dhe rifillimin e bisedimeve. Për Kosovën, kjo nënkupton heqjen e taksave të vendosura ndaj Serbisë. Për Serbinë, kjo nënkupton ndërprerjen e fushatës për heqjen e njohjeve kundër Kosovës", është thënë në deklaratën për medie të Quintit. Pas kësaj deklaratë ka reaguar edhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, i cili ka thënë se Kosova mund ta mbrojë interesin e vet në bisedimet me Serbinë vetëm me partnerët e vet strategjikë.

"Prandaj, mirëpresim përpjekjet e ShBA-së, të BE-së, të Gjermanisë, të Britanisë së Madhe, të Francës dhe të Italisë për zhvillimin e dialogut. Megjithatë, kërkohet nga BE-ja ta parandalojë financimin e strukturave paralele në Kosovë nga Qeveria e Serbisë, t'ia ndalojë projektet kolonizuese serbe përmes ndërtimit të lagjeve në veri, të lejohet rindërtimi i shtëpive të djegur atje ku shqiptarët jetonin para vitit 2001, si dhe të dënohen kriminelët dhe përdhunuesit serbë për krimet e kryera ndaj shqiptarëve të pafajshëm gjatë dhe pas luftës në Kosovë", kishte shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook". Ndërsa njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare qëndrimin e fundit të vendeve të Quintit e kanë parë si shpresë për rikthim të palëve në tavolinën e dialogut. Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka deklaruar se me këtë qëndrim vendet e Quintit po i trajtojnë palët në mënyrë të barabartë, gjë të cilën deri më tani nuk e ka bërë BE-ja. "Quinti më në fund e bëri atë që nuk e bënte BE-ja: ktheu simetrinë ndaj trajtimit të të dy palëve me dy kërkesa: koncesione reciproke për secilën prej tyre. Deri më tash Brukseli kërkonte koncesione vetëm nga njëra palë, pra që vetëm Kosova ta hiqte taksën, por jo edhe që Serbia t'i hiqte bllokadat diplomatike për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare", ka thënë Reka. Ai ka bërë me dije se me këtë qëndrim vendet më të fuqishme perëndimore kanë dhënë shpresë për një rifillim të dialogut me një mandat të ri. "Konsideroj se Quinti, me një qëndrim të tillë të ekuidistancës ndaj dy palëve të barabarta negociuese, dha shpresë për rifillimin e dialogut, por tash me një mandat të ri, format të ri dhe me trajtim të ri të barabartë ndaj dy palëve negociuese. Fundja, qëndrimin e Quintit pak a shumë e kishte paralajmëruar iniciativa e fundit Merkel-Makron, e filluar në pranverë në Berlin dhe me gjasë me vazhdim në vjeshtë në Paris", është shprehur ai.



Daçiçi: Tërheqja e njohjeve të Kosovës, proces i pandalshëm

PRISHTINË, 15 GUSHT - Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiçi, ka thënë se tërheqja e njohjeve të Kosovës është proces i pandalshëm dhe i pakthyeshëm. Sipas tij, këtë javë është dashur të shpallet edhe një vendim i ri për tërheqje të njohjes, por

Serbia "nuk dëshironte të krijonte shqetësime gjatë kësaj jave". "Nuk kemi dashur ta dëmtojmë shëndetin e atyre që shkruajnë deklaratat e Quintit dhe këtyre në Prishtinë", ka thënë Daçiçi në një intervistë për televizionin "Prva".

Deklarata e ministrit të Jashtëm të Serbisë bëhet dy ditë pasi vendet e Quintit (Franca, Gjermania, Italia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara) përmes një deklaratë kanë kërkuar nga Kosova dhe Serbia t'i shmangin veprimet që

do të pengonin një marrëveshje përfundimtare. "Për Kosovën, kjo nënkupton heqjen e taksave të vendosura ndaj Serbisë. Për Serbinë, kjo nënkupton ndërprerjen e fushatës për tërheqjen e njohjeve kundër Kosovës", është thënë në deklaratë.



Flet për "Epokën e re", Time Kadrijaj

Gjykata Speciale



Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadrijaj, e ka quajtur padrejtësi të madhe ballafaqimin e ish-ushtarëve të UÇK-së me Gjykatën Speciale. Ajo ka treguar se ende nuk e di se në çfarë cilësie do të paraqitet në këtë gjykatë, megjithatë ka thënë se do t'i përgjigjet pozitivisht çfarëdo ftese. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kadrijaj ka deklaruar se kjo gjykatë do të dështojë meqë, sipas saj, nuk ka çfarë të thuhet dhe të dëshmohet përveç pastërtisë së luftës së UÇK-së. Kadrijaj ka folur edhe për zhvillimet e fundit politike, me ç'rast ka theksuar se më 22 gusht Kuvendi do të shpërndahet dhe vendi do të shkojë në zgjedhje. Ajo ka deklaruar se AAK-ja do të jetë befasia e këtyre zgjedhjeve

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 15 GUSHT - Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadrijaj, ka thënë të enjten se Gjykata Speciale do të dështojë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka deklaruar se ish-luftëtarët do ta dëshmojnë pastrinë e luftës së UÇK-së në Speciale. "Secili luftëtar që do të ftohet nga Specialja do të dalë fitimtar dhe do të dëshmojë se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe e shenjtë. Gjykata Speciale do të dështojë, sepse nuk ka çka të thuhet dhe nuk ka çka të dëshmo-

het përveç pastërtisë së luftës së UÇK-së", është shprehur Kadrijaj. Ajo e ka quajtur të padrejtë ballafaqimin me këtë gjykatë, megjithatë ka bërë me dije se do t'i përgjigjet pozitivisht ftesës së saj. Kadrijaj ka treguar se nuk e di ende se në çfarë cilësie do të ftohet nga Gjykata Speciale meqë ende nuk e ka marrë ftesën zyrtare. "Unë jam kontaktuar me telefon nga Gjykata Speciale, por zyrtarisht ende nuk e kam marrë ftesën. Përderisa nuk e kam marrë ftesën zyrtare nuk e di se në çfarë cilësie do të ftohem", ka theksuar ajo, duke shtuar se Gjykata Speciale është turpi më i madh që i kanë bërë Kosovës. "Është turpi i bashkësisë evropiane që të bëjë

një Gjykatë Speciale njëetnike dhe të gjykohe krimet e supozuara të UÇK-së, kurse Serbia, e cila ka qenë nxitëse e të gjitha luftërave në Ballkan, të mos gjykohe për krimet dhe gjenocidin e kryer në Kosovë. Si mund të barazohet kriminelin me luftëtarin që ka mbrojtur popullin dhe prapun e shtëpisë? Ky është turp. Unë nuk e kam votuar Gjykatën Speciale sepse mendoj se është një padrejtësi e madhe që po i bëhet Kosovës nga faktori ndërkombëtar", ka thënë Kadrijaj. Në këtë intervistë ajo ka folur edhe për zhvillimet e fundit politike, me ç'rast ka theksuar se më 22 gusht Kuvendi do të shpërndahet dhe vendi do të shkojë në zgjedhje. "Po

shihet se të gjitha partitë politike janë të gatshme për zgjedhje. Edhe ne si Aleancë jemi të përgatitur për zgjedhje dhe po punojmë në terren me struktura", ka thënë Kadrijaj, duke shtuar se AAK-ja do të jetë befasia e zgjedhjeve të parakohshme. "Kohët e fundit kemi aderime të shumta dhe ky është rezultat i qeverisjes së mirë të kryeministrit Haradinaj. Ai ia ka kthyer dinjitetin Kosovës me vendimet e mëdha që i ka marrë siç janë: formimi i ushtrisë, vendosja e taksës, Ligji i 'Trepçës', Ligji i Pagave, Ligji i Prishtinës dhe vendime të tjera të cilët drejtpërdrejt prekin qytetarët e vendit. Këto kanë bërë që Aleanca të shënojë rritje dhe këtë po e konfirmojnë edhe sondazhet vendore dhe ndërkombëtare. Sipas sondazheve, AAK-ja po radhitet ndër partitë e para dhe mendoj se me këtë ritëm Aleanca do të jetë befasia e këtyre zgjedhjeve", është shprehur Kadrijaj.

"Epoka e re": Znj. Kadrijaj, ju tashmë jeni kontaktuar nga Gjykata Speciale. Mund të na tregoni se në çfarë cilësie keni pranuar ftesën?

Kadrijaj: Unë jam kontaktuar me telefon nga Gjykata Speciale dhe zyrtarisht ende nuk kam marrë

ftesë. Përderisa nuk e kam marrë ftesën zyrtare nuk e di se në çfarë cilësie do të ftohem.

"Epoka e re": Si e shihni përballjen tuaj dhe të ish-luftëtarëve të UÇK-së me këtë gjykatë?

Kadrijaj: E kam thënë dhe vazhdoj ta them, se Gjykata Speciale është turpi më i madh që ia kanë bërë Kosovës. Është turpi i bashkësisë evropiane që të bëjë një Gjykatë Speciale njëetnike dhe të gjykohe krimet e supozuara të UÇK-së, kurse Serbia, e cila ka qenë nxitëse e të gjitha luftërave në Ballkan, të mos gjykohe për krimet dhe gjenocidin e kryer në Kosovë. Si mund të barazohet kriminelin me luftëtarin që ka mbrojtur popullin dhe prapun e shtëpisë? Ky është turp. Unë nuk e kam votuar Gjykatën Speciale sepse mendoj se është një padrejtësi e madhe që po i bëhet Kosovës nga faktori ndërkombëtar. Gjithë ky maltretim që po u bëhet ushtarëve të UÇK-së në 20 vjetët e pasluftës nuk do asnjë koment. Është e papranueshme që atyre nuk po u lejohet të jetojnë të qetë dhe ta shijojnë lirinë.

"Epoka e re": Sa do të jetë i vështirë ballafaqimi me këtë gjykatë?

do të dështojë

të tillë pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj për shkak të ftesës nga Specialja. Tashmë është caktuar mbajtja e seancës më 22 gusht për shpërndarjen e Kuvendit dhe me automatizëm do të hyjmë në fazën zgjedhore. Po shihet se të gjitha partitë politike janë të gatshme për zgjedhje. Edhe ne si Aleancë jemi të përgatitur për zgjedhje dhe po punojmë në terren me struktura. Kohët e fundit kemi aderime të shumta dhe ky është rezultat i qeverisjes së mirë të kryeministrit Haradinaj. Ai ia ka kthyer dinjitetin Kosovës me vendimet e mëdha që i ka marrë siç janë: formimi i ushtrisë, vendosja e taksës, Ligji i 'Trepçës', Ligji i Pagave, Ligji i Prishtinës dhe vendime të tjera të cilët drejtpërdrejt prekin qytetarët e vendit. Këto kanë bërë që Aleanca të shënojë rritje dhe këtë po e konfirmojnë edhe sondazhet vendore dhe ndërkombëtare.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet tuaja nga këto zgjedhje?

Kadrijaj: Sipas sondazheve, AAK-ja po radhitet ndër partitë e para dhe mendoj se me këtë ritëm Aleanca do të jetë befasia e këtyre zgjedhjeve. AAK-ja është e përgatitur dhe kemi besim se Haradinaj do ta marrë besimin për ta udhëhequr edhe më tutje vendin dhe do t'i përfundojë me sukses temat që janë në interes të Kosovës dhe popullit të saj. Bazuar edhe në sondazhet e fundit, Haradinaj është kandidati më i pëlqyer për kryeministër.

"Epoka e re": AAK-ja do të garojë e vetme dhe me Haradinajn kandidat për kryeministër apo me koalicion dhe me një kandidat tjetër?

Kadrijaj: Po punojmë që AAK-ja të shkojë e vetme në zgjedhje, por jemi të hapur për Nismën, PSD-në, AKR-në dhe të tjerat që dëshirojnë të garojnë së bashku. Mirëpo kjo gjë do të varet nga zhvillimet politike dhe nuk do të dihet deri në çastet e fundit. Megjithatë, ne kemi thënë se nuk kemi vija të kuqe për asnjë parti politike. Në bazë të zhvillimeve do të veprojë edhe Aleanca. Për koalicionet parazgjedhore apo paszgjedhore vendosin Këshilli Drejtues dhe Kryesia e Aleancës.

"Epoka e re": Po shihet një gatishmëri për arritjen e koalicionit LDK-LV. Në rast se ndodh ky koalicion, a do të ketë përsëritje të PAN-it?

Kadrijaj: Nuk kemi vendosur për koalicion, pra jemi të gatshëm të garojmë vetëm, por edhe me koalicion. Për cilindo variant që

vendos Këshilli Drejtues dhe kryesia e partisë, ashtu do të veprojë.

"Epoka e re": Zyrtarët e këtyre dy partive po thonë se një koalicion i tillë është duke e frikësuar PAN-in. Është e vërtetë se po frikësoheni nga koalicioni parazgjedhor LDK-LV?

Kadrijaj: Jo, nuk po i frikësohemi

një koalicioni të tillë. Në fakt, secili subjekt politik ka të drejtën e vet legjitime për të vendosur se me kë dëshiron të bëjë koalicion. Megjithatë, do të jetë i çuditshëm një koalicion i tillë për shkak të politikave programore, sepse janë dy subjekte krejtësisht të kundërta. LDK-ja është parti e

djathhtë, kurse LV-ja është parti e majtë. Duke pasur parasysh gjuhën e ashpër që ka përdorur LV-ja karshi LDK-së dhe sulmet ndaj liderit të saj, është i çuditshëm një bashkëpunim i tillë. Megjithatë, ja që në politikë gjithçka është e mundur.

Përrurohet aparatura e re në Klinikën e Kirurgjisë Torakale

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka përruar të enjten pajisjet e reja në Kirurgjinë Torakale në QKUK. Për herë të parë kjo klinikë është pajisur me VATS në vlerë prej 64 mijë eurosh. Kjo aparaturë rrit cilësinë dhe sigurinë e ndërhyrjes, zvogëlon mundësinë për infeksione dhe përshejton kohën e rehabilitimit të pacientit. Ministri Ismaili, gjatë përrurimit të këtyre pajisjeve, ka thënë se duke luftuar korrupsionin në shëndetësi është bërë e mundur që të kursehen më shumë para të cilat po kthehen në investime për klinikat dhe spitalet tona. "Sot në

Kirurgjinë Torakale përruam pajisjen e re të VATS-it dhe Bronkoskopin që bashkë kapin vlerën e 74 mijë eurove. VATS-i i ri do të rritë shumë sigurinë e pacientit në operacione dhe do të mundësojë rehabilitim më të shpejtë të tij. Meqenëse operimet e tilla në privat sillen nga 25 deri në 40 mijë euro, ne kemi bërë një ndërhyrje që prekë jetën e pacientëve dhe buxhetin e familjeve", ka thënë ministri Ismaili.

Më tutje, ai ka thënë se duke luftuar korrupsionin ka nisur të kthehet shpresa dhe besimi i qytetarëve në sistemin tonë shëndetësor. "Milionë euro të shpëtuar në blerjen e barnave i kemi kthyer në orientimin e duhur: në më shumë aparaturë moderne për klinikat dhe spitalet tona të

cilat tani janë në shërbim të plotë të pacientëve, qytetarëve dhe familjeve", ka thënë ministri Ismaili.

Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka thënë se të gjitha këto investime po bëhen në vazhden e modernizimit të pajisjeve në QKUK që pacientëve t'u ofrohen më shumë shërbime. Ndërkaq drejtori i Klinikës së Kirurgjisë Torakale, Saudin Maliqi, ka thënë se tani e tutje kjo klinikë do të ofrojë shërbime që nuk i ka ofruar më parë. "Për herë të parë do ta nisim ofrimin e këtyre shërbimeve të cilat më parë qytetarët i kanë marrë jashtë vendit. Po ashtu, përmes këtyre pajisjeve pacientët më nuk do të kenë nevojë të qëndrojnë 12 ditë në spital, por maksimumi dy ditë", ka thënë ai.



Kadrijaj: Përballja me këtë gjykatë është një padrejtësi e madhe. Është e padrejtë që kryeministri Haradinaj është gjykuar dhe është shpallur dy herë i pafajshëm nga Gjykata e Hagës e ftohet të gjykohej edhe nga Gjykata Specialja. Haradinaj, Limaj, Ibrahimaj dhe të tjerët kanë dalë fitimtarë, duke mbrojtur luftën e drejtë dhe të shenjtë të UÇK-së. Secili luftëtar që do të ftohet nga Specialja do të dalë fitimtar dhe do të dëshmojë se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe e shenjtë.

"Epoka e re": Jeni optimiste se do ta fitoni betejën me Gjykatën Speciale?

Kadrijaj: Ndonëse është e padrejtë ne duhet të përballemi me këtë gjykatë. Sikurse ish-luftëtarët e UÇK-së, edhe unë do t'i përgjigjem Gjykatës Speciale. Por vetë fakti që kjo gjykatë ka ftuar një mjekë tregon çfarë gjykate është. Gjykata Speciale do të dështojë, sepse nuk ka çka të thuhet dhe nuk ka çka të dëshmohet përveç pastërtisë së luftës së UÇK-së.

"Epoka e re": Znj. Kadrijaj, si po i shihni zhvillimet e fundit në skenën politike?

Kadrijaj: Gjendemi në një situatë

Fillojnë punimet për ndërtimin e rrugës Xërxë-Sapniq-Ratkoc

RAHOVEC, 15 GUSHT (ER) - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me ministrin e Infrastrukturës, Pal Lekaj, dhe zëvendësministrin Rexhep Kadriu ishin në Ratkoc dhe Xërxë me rastin e fillimit të

punimeve për ndërtimin e rrugës Xërxë-Sapniq-Ratkoc. "Ky projekt shumë i rëndësishëm për banorët e kësaj ane, që financohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit e që zbatohet nga komuna e

Rahovecit, kap vlerën e 898,888 eurove dhe ka gjatësi 12 mijë metra, shenjzëm horizontal vertikal dhe shtegun për çiklizëm. Falënderojmë ministrin Lekaj për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë

Komunës së Rahovecit me projekte infrastrukturore", ka thënë kryetari Latifi. Ai ka theksuar se asfaltimi i kësaj rruge ka rëndësi të madhe për fermerët dhe bujqit e kësaj zone.



Ministria e Arsimit fillon ndërtimin e një çerdheje të re në Klinë

KLINË, 15 GUSHT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, së bashku me kryetarin e Komunës së Klinës, Zenun Elezajn, kanë vënë gurthemelin për ndërtimin e një çerdheje të re në Klinë.

Gjatë qëndrimit në këtë qytet ministri Bytyqi ka vizituar edhe punimet e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Ismet Rraci", e cila pritet të jetë e gatshme në fillim të këtij viti shkollor. "Është kënaqësi që sot jemi në Klinë dhe që vumë gurthemelin e një projekti shumë të rëndësishëm, siç është çerdhja e fëmijëve. Uroj banorët e Komunës së Klinës dhe kryetarin që tani e tutje do

të kenë edhe një çerdhe. Uroj, po ashtu, që të kemi sa më shumë infrastrukturë për edukimin e hershëm, për arsye se kjo është në të mirë të edukimit të përgjithshëm të fëmijëve tanë", është shprehur ministri Bytyqi.

Ministri Bytyqi dhe kryetari Elezaj kanë zhvilluar edhe një takim gjatë ditës së sotme për zhvillimet në arsim, me theks për arsimin e komunës së Klinës, si dhe për përpjekjet e përbashkëta për ngritje të cilësisë. Në këtë ceremoni ishte e pranishme edhe deputetja e zonës, Mirjeta Kalludra. Ky projekt është investim i Ministrisë së Arsimit dhe kapë vlerën mbi 500 mijë euro.



Reshjet dhe erërat e fuqishme kanë shkaktuar dëme materiale në Gjilan

GJILAN 15 GUSHT (ER) - Komuna e Gjilanit ka kaluar një mot me reshje shiu dhe me erëra të fuqishme të cilat kanë lënë vetëm dëme materiale, pa pasoja në njerëz dhe në paluejtshmëri. Nën kryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, pas vizitës në terren, ka thënë se erërat e fuqishme të cilat kanë zgjatur për një kohë të shkurtër kanë shkaktuar dëme materiale, por pa lëndime në njerëz. "Kemi vizituar pjesën më të madhe në Komunën e Gjilanit. Përpos raportimeve për dëme materiale, fatmirësisht nuk kemi lëndime në njerëz. Deri më tani kemi hasur në një shtyllë elektrike të thyer, drunj të rrëzuar, disa vetura të dëmtuara dhe në lokacione të ndryshme ka dëmtime të kul-



turave bujqësore dhe dëmtim të shtandëve në rrugën e Përlepnicës. Gjilani është duke kaluar një fazë të kujdesit të lartë për tejkalimin e thatësisë, por

reshjet e mbrëmshme, përpos zbritjes së temperaturave të larta, nuk kanë shënuar ndonjë ndryshim në grumbullimin e ujit të pijshëm", ka thënë Ismajli.

Në Qendrën Rinore të Malishevës përrurohet kabineti i IT-së me pajisje të reja

MALISHEVË, 15 GUSHT (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar të enjten Qendrën Rinore të Malishevës. Ai së bashku me të rinjtë dhe vullnetarët e kësaj shtëpie rinore përruroi kabi-

netin e IT-së me pajisje të reja, të cilat janë donacion i Ministrisë së Rinisë për të rinjtë e Malishevës. "Investimet në fushën e rinisë janë investime për të tashmen dhe të ardhmen e vendit tonë", ka thënë Gashi.



Kanë filluar punimet për meremetimin e lapidarit në Lladrovç

MALISHEVË, 15 GUSHT (ER) - Në kuadër të mirëmbajtjes dhe rregullimit të lapidarëve, kanë filluar punimet për meremetimin dhe rregullimin e lapidarit të dëshmorëve në fshatin Lladrovç të Malishevës. Fillimin e punimeve në këtë lapidar e kanë parë nga afër kryetari i

Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe nënkryetari Hajdin Berisha.

Begaj dhe Berisha janë interesuar për punën që ka filluar në meremetimin e pjesëve të dëmtuara të këtij lapidari si dhe kanë kërkuar që projekti të zbatohet në tërësi sipas

planifikimit të paraparë.

Ky projekt realizohet në kuadër të mirëmbajtjes dhe kujdesit për monumentet historike në Komunën e Malishevës, si pjesë e trashëgimisë historike, përkatësisht të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prishtina dhe Vushtrria, komunat më të suksesshme



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 15 GUSHT - Zëvendësudhëheqësja e Misionit të USAID-it në Kosovë, Zeinah Salahî, së bashku me Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), lansuan Indeksin e Transparencës në Prokurimin Publik. Indeksi tregon përparim të konsiderueshëm në transparencën e prokurimit publik në nivel lokal.

Përderisa ndryshimet në legjislacionin sekondar kontribuuan për rritjen e transparencës në e-Prokurimi, vullneti politik në nivelin lokal në vitin 2018 shënoi përparim, pasi dokumente të rëndësishme siç janë kontratat, vendimet për ankesat e shkallës së parë, rregulloret për ndarjen e granteve dhe informacionet mbi procesin e vlerësimit për këto grante, filluan të publikohen në faqet e internetit të komunave. Diana Metushi-Krasniqi,

menaxhere e projektit në KDI, ka paraqitur gjetjet kryesore të raportit. "Edhe pse këtë vit kemi një rritje të transparencës prej 28 përqindësh kundrejt vitit paraprak, megjithatë mesatarja e performancës në gjashtë shtyllat e matura është vetëm 58 përqind. Komunat duhet t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre për rritjen e transparencës në 43 indikatorë", ka thënë ajo.

Metushi-Krasniqi ka shtuar se ky indeks tregon se komunat, krahas rritjes së transparencës, duhet të fokusohen në krijimin dhe zbatimin e mekanizmave llogaridhënës. Ky prezantim mbledhi aktorët kryesorë nga Qeveria e Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile.

Gjatë kësaj ngjarjeje, zëvendësudhëheqësja e Misionit të USAID-it në Kosovë, Zeinah Salahî, ka thënë se prokurimi transparent është një element kyç në rritjen e përgjegjësisë dhe luftimin e korrupsionit në çdo

vend për çdo qeveri. "Në Kosovë kjo reformë është shumë e rëndësishme pasi që gjysma e buxhetit të vendit shpenzohet përmes prokurimit publik në nivel kombëtar ose komunal", ka thënë ajo.

Ndërsa sekretarja e përgjithshme e MAPL-së ka pohuar se monitorimi i transparencës komunale nga sektori joqeveritar paraqet një shtysë të fortë për institucionet publike që të punojnë në zbatimin e standardeve më të mira të administrimit publik, në të mirë të krijimit të asaj që njihet si qeverisje e hapur dhe transparente, duke ndërtuar mekanizma efikas ligjorë që qytetarët të jenë sa më pranë bazës së informacionit.

Arben Kelmendi, koordinator i programit të KDI-së, ka thënë se Instituti Demokratik i Kosovës vazhdon traditën e publikimit të Indeksit të filluar qysh në vitin 2014. "Një qeveri komunale që i

bën informatat lehtë të qasshme për publikun, inkurajon një qytetari aktive dhe mundëson ndërtimin e një procesi vendim-marrës gjithëpërfshirës dhe mirë të informuar", është shprehur Kelmendi.

Gjatë organizimit të pranishmëve iu drejtuan edhe kryetarët e dy komunave më të suksesshme, kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, dhe ai i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri. "Do të publikojmë çdo dokument në mbajtje sipas ligjit brenda 15 ditëve që t'ua japim qytetarëve informacionin e plotë. Kjo nuk do të thotë se nuk kemi gabime dhe që MAPL dhe OShP nuk na kanë kthyer vendime. Rruga përpara për Kosovën është transparenca e plotë në çdo vendim. Qeverisja e mirë nuk duhet të jetë në mëshirë të politikanëve, por duhet ndërtuar sisteme funksionale", ka thënë Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës së Prishtinës.

Ndërsa kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka thënë se është shumë i lumtur që për më pak se dy vjet të udhëheqjes ka bërë këtë kapërcim komunal. "Prioriteti ynë ka qenë që të japim shembull për praktika të mira si komunë. Jemi komuna e parë që kemi aprovuar kodin e etikës si dhe planin e integritetit. Deklarata e kodit të etikës është e nënshkruar nga secili zyrtar dhe gjendet në dosjen e tij/saj. Edhe në uebfaqe edhe në rrjetet sociale i kemi publikuar të gjithë përfuturit e subvencioneve. Ne kemi përfshirë edhe shoqërinë civile në qytetin tonë, edhe pse nuk është e nivelit të organizimit sikurse në Prishtinë", ka thënë Tahiri.

Indeksi i Transparencës në Prokurimin Publik është zhvilluar nga KDI-ja përmes grantit nga aktiviteti i USAID-it për komuna transparente, efektive dhe llogaridhënës.

Investimet në qendrat korrektuese parandaluan dukuritë negative

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 15 GUSHT - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka takuar të enjten drejtorin e përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi, dhe drejtorët e qendrave korrektuese të Kosovës. Tahiri ka vlerësuar punën e bërë në dy vjetët e fundit që ka rezultuar me ndryshime të mëdha në menaxhimin e qendrave korrektuese. "Sistemi korrektues ka shënuar avancim jashtëzakonisht të madh përgjatë dy vjetëve të fundit. Me përkushtim dhe angazhim të vazhdueshëm ia kemi arritur ta transformojmë perceptimin dhe imazhin e qendrave korrektuese. Kemi përmirësuar instruktuarën dhe kemi shtuar kapacitetet. Është rritur siguria si dhe janë luftuar dhe parandaluar dukuritë nega-

tive brenda tyre", ka thënë ministri Tahiri.

Përveç funksionit korrektues, ministri Tahiri ka theksuar se qendrat kanë edhe funksion risocializimi, detyrë kjo që u arrit të përmbushet falë angazhimit të punëtorëve në baza ditore. "Sot, qendrat korrektuese i plotësojnë të gjitha standardet bashkëkohore dhe të njëjtat, krahas funksionit korrektues, kanë edhe funksion të plotë risocializimi. I tërë ky progres nuk do të mund të bëhej pa përgjegjësit dhe oficerët e këtij shërbimi, që në baza ditore menaxhojnë këto qendra", është shprehur Tahiri. Gjatë këtij takimi ministri Tahiri dhe drejtuesit e institucioneve korrektuese ndanë perspektivën e reformimit të mëtejshëm dhe hapat që po ndërmerren për avancimin e shërbimit korrektues në të gjitha dimensionet e tij.



Punëtorët e aeroportit nga e hëna fillojnë grevën

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 GUSHT - Punëtorët e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" kanë vendosur që të hyjnë në grevë më 19, 20 dhe 21 gusht. Nëpërmjet një njoftimi për medie Sindikata e Aeroportit "Adem Jashari" ka bërë me dije se pas shumë përpjekjeve për të dialoguar me menaxhmentin rreth kërkesave të tyre, këta të fundit nuk kanë treguar gatishmëri për dialog. "Ju njoftojmë se pas shumë përpjekjeve dhe kërkesave të shumta drejtuar menaxhmentit të aeroportit për të dialoguar dhe për t'i zgjidhur çështjet tona në mënyrë paqësore, deri më tani nuk kemi pranuar ndonjë ftesë apo gatishmëri nga ana e menaxhmentit për të dialoguar. Ne kemi shterur

të gjitha mënyrat dhe mundësitë paqësore për dialog. Punëtorët janë të vendosur në kërkesat e tyre për çka edhe kanë vendosur përmes delegatëve të tyre të shkojnë në grevë, siç kemi paralajmëruar në protestën paqësore të mbajtur javën e kaluar më 8 gusht se më 19 gusht do të kemi grevë njëorëshe duke filluar prej orës 8:00 deri në orën 09:00 sipas kohës lokale dhe më 20 gusht grevë dyorëshe duke filluar prej orës 08:00 deri në orën 10:00, si dhe më 21 gusht do të mbajmë grevë gjithëditore", është thënë në njoftimin e kësaj sindikate.

Sipas këtij njoftimi, në grevë do të marrin pjesë të gjithë punëtorët e shërbimeve që nuk janë të rëndësishëm jetike.

Sindikalistët e Aeroportit "Adem Jashari" kanë ftuar menaxhmentin që të koordinohet me



këtë sindikatë për ta caktuar minimumin e shërbimeve në mënyrë që të garantohet siguria dhe të evitohet çfarëdo rrezikimi i jetës dhe sigurisë. Gjithashtu, në këtë njoftim është theksuar se greva do të ndërpritet në ndonjë rast emergjent. Sindikata e Aeroportit "Adem Jashari" edhe një herë ka ftuar menaxhmentin

në dialog, në mënyrë që greva të ndalohet.

Ndërsa Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) "Adem Jashari" ka bërë me dije se të gjitha fluturimet e parapara për datat kur është paralajmëruar greva e punëtorëve të këtij aeroporti do të realizohen me kohë. "Dëshirojmë t'i njoftojmë të

gjithë udhëtarët që kanë planifikuar të udhëtojnë përmes Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari', se të gjitha fluturimet e planifikuara më datat 19, 20 dhe 21 gusht do të realizohen në kohë", ka njoftuar Zyra për Informim e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".

O'Conelli thotë se duhet të thellohet bashkëpunimi ekonomik Kosovë - Britani



PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të enjten në një takim lamtumirës ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, Ruairi O'Connell. Ministri Shala e ka falënderuar ambasadorin O'Connell për mbështetjen që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë Kosovës për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për forcimin e institucioneve. "Mirënjohje për Mbretërinë e Bashkuar dhe për ambasadorin O'Connell për mbështetjen e vazhdueshme që po jepni për Kosovën për forcimin e institucioneve tona. Republika e Kosovës dhe

Mbretëria e Bashkuar kanë marrëdhënie të shkëlqyera dhe shpresoj që shpejt këto marrëdhënie do të thellohen edhe në aspektin ekonomik, duke i rritur shkëmbimet tregtare", ka thënë ministri Shala. Ndërsa ambasadori Ruairi O'Connell ka falënderuar ministrin Shala për bashkëpunimin, duke theksuar se Mbretëria e Bashkuar do të vazhdojë të jetë përkrahëse e Kosovës. Ambasadori O'Connell ka theksuar se Mbretëria e Bashkuar dhe Kosova kanë marrëdhënie shumë speciale, njëkohësisht ka vlerësuar se duhet të thellohet edhe bashkëpunimi ekonomik.

BERZh-i ofron 25 milionë euro kredi për investime në Ferronikel

PRISHTINË, 15 GUSHT - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) ka njoftuar se do të ofrojë 25 milionë euro kredi për investime në kompaninë NewCo Ferronikeli.

"NewCo Ferronikeli Complex LLC", një nga operatorët më të mëdhenj në fushën minerare dhe metalurgjike në Ballkan, është blerë nga "Grupi Balfin". Samir Mane, themelues dhe pronar i kompanisë "Balfin", ka thënë se është krenar për ta vazhduar historinë e bashkëpunimit me BERZh-in. "Investimet që do të bëjmë në Ferronikel do të sigurojnë se ai mbetet një prodhues konkur-

rent i nikelit në ekonominë globale dhe vazhdon të hapë vende të punës në Kosovë", ka thënë ai.

Eric Rasmussen, drejtor i BERZh-it për Burime Natyrore, ka thënë se "BERZh-i është i lumtur që do të bashkëpunojë me kompaninë 'Balfin' për rimëkëmbje të Ferronikelit, që është i rëndësishëm për Kosovën dhe komunitetin lokal".

Kjo kompani pati ndërprerë prodhimin për një periudhë vitin e kaluar për shkak të problemeve financiare me të cilat është ballafaquar pronari i mëhershëm.



Rriten kapacitetet prodhuese vendore, por edhe çmimet



"Nëse e krahasojmë gjashtëmujorin e vitit 2018 me gjashtëmujorin e këtij viti, statistikat tregojnë se ne kemi rritje të kapaciteteve prodhuese për 30 për qind. Në treg është rritur kërkesa për produktet tona dhe ne kemi shtuar kapacitetet prodhuese", ka thënë Bedri Kosumi, pronar i kompanisë "Pestova"

PRISHTINË, 15 GUSHT - Taksa 100 për qind e vendosur nga Qeveria e Kosovës nëntë muaj më parë për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina ka ndaluar pothuajse në tërësi eksportin e këtyre dy vendeve në Kosovë. Të dhënat e Doganës së Kosovës flasin për një eksport minimal të produkteve të këtyre dy shteteve në Kosovë. Zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se nëntë muaj eksporti i produkteve të këtyre dy vendeve në Kosovë ka qenë 11 milionë euro, derisa para vendosjes së taksës vetëm për një ditë eksporti nga këto dy vende ka qenë mbi 1.4 milion euro. "Të dhënat e

Doganës tregojnë se kemi një rënie të theksuar të importit nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Nga Bosnja e Hercegovina rënia e eksportit është 98 për qind, ndërsa nga Serbia është rreth 97 për qind. Kjo mund të quhet ndalje komplet e importit krahasuar me vlerën që ka qenë para vendosjes së taksës", ka thënë Stavileci. Vendosja e kësaj takse nga përfaqësues të bizneseve thuhet të ketë pasur një ndikim pozitiv në industrinë prodhuese, pasi disa prej këtyre produkteve që vinin nga këto dy shtete, në veçanti nga Serbia, u zëvendësuan me produktet vendore. Bedri Kosumi, pronar i kompanisë "Pestova", e cila merret

me përpunimin dhe prodhimin e patates, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se kanë rritur kapacitetet prodhuese që nga vendosja e taksës. "Nëse e krahasojmë gjashtëmujorin e vitit 2018 me gjashtëmujorin e këtij viti, statistikat tregojnë se ne kemi rritje të kapaciteteve prodhuese për 30 për qind. Në treg është rritur kërkesa për produktet tona dhe ne kemi shtuar kapacitetet prodhuese", ka thënë Kosumi. Rritja e kapaciteteve prodhuese, thotë Kosumi, bëri që të rritet edhe numri i punëtorëve. "Aktualisht kemi 252 punëtorë të rregullt derisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë qenë rreth 200 punëtorë", është shprehur Kosumi. Për efektet e taksës në prodhimin vendor disa shoqata ekonomike në Kosovë kanë realizuar disa hulumtime. Hulumtimet e këtyre organizatave si Aleanca Kosovare e Biznesit dhe Klubi i Prodhueseve të Kosovës tregojnë se janë rritur kapacitetet prodhuese dhe është rritur numri i të punësuarve në industrinë prodhuese.

Taksa 100 për qind për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina pati një ndikim në rritjen e çmimeve të konsumit, sipas disa qytetarëve të anketuar nga "Radio Evropa e Lirë". Valmira Kelmendi, banore e Prishtinës, thotë se çmimet janë rritur, në veçanti ato të konsumimit. "Çmimet janë rritur gradualisht, por në muajin korrik kam vërejtur një ndryshim të madh të çmimeve, në veçanti artikujt ushqimorë. Edhe pse flitet që taksa 100 për qind nuk ka ndikuar, unë mendoj se kjo ka bërë që çmimet në vend të shënojnë rritje", ka thënë Kelmendi. Ngjashëm shprehet edhe Merita Kastrati. "Po mendoj se në ngritjen e çmimeve ka ndikuar taksa, çmimet janë rritur, disa produkte në treg janë zëvendësuar me produkte nga vendet e tjera, por edhe vendore ndoshta janë më cilësore, por janë më të shtrenjta", thotë ajo. Një ngritje e çmimeve të konsumit është e evidentuar edhe në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).

"Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 2,6 për qind në muajin korrik 2019 krahasuar me muajin korrik 2018. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit; buka dhe drithërat kanë shënuar rritje për 14 për qind, mishi për 4.7 për qind, perimet 1.2 për qind, rritje kanë shënuar edhe produktet e tjera", thuhet në të dhënat e ASK-së. Qeveria e Kosovës në muajin nëntor të vitit të kaluar pati vendosur taksë doganore 100 për qind për mallrat me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Vendosja e kësaj takse ishte si kundërpërgjigje ndaj politikave të Beogradit dhe Sarajevës në raport me shtetin e Kosovës. Qeveria e Francës, e Gjermanisë, e Italisë, e Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës ditë më parë i kanë bërë thirrje Kosovës për heqjen e taksave të vendosura ndaj Serbisë në mënyrë që të vazhdojë dialogu në mes të Prishtinës dhe Beogradit për normalizim të marrëdhënieve.

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (18)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti: Selatin NOVOSELLA

Lavdi veprës dhe punës së palodhur heroike të Bacës Adem!

30 korrik 2018, R. Shehu

Figura Jote më ka frymëzuar qysh kur isha i ri dhe prapë do më shoqërojë tërë jetën, Heroi im! Lavdi dhe respekt për jetë e mot!

30 korrik 2018, Mentor Mushkolaj

Çdo herë do ta vazhdojmë veprën tuaj, i madhi i kombit shqiptar!

30 korrik 2018, (nënshkrimi i palexueshëm)

Ti je i pavdekshëm te populli ynë!

30 korrik 2018, (nënshkrimi i palexueshëm)

Respekt për veprën tende jetësore, e cila do jetojë ndër shekuj!

30 korrik 2018, Sahit Murturi

Krenaria e kombit shqiptar, respekt jetës dhe veprës tënde deri në përjetësi! Lavdi të qoftë për atë që bërë për popullin tënd!

30 korrik 2018, (nënshkrimi i palexueshëm)

Ngushëllimet më të sinqerta për njeriun më të madh të kombit tonë, nga Universiteti i Prishtinës, "Hasan Prishtina"!

30 korrik 2018, (pesë nënshkrime të palexueshme)

Baca Adem, të nderon përherë me respekt meritë, Zenel Bajgora!

30 korrik 2018, Zenel Bajgora

Respekt i veçantë, veprimtarit më të dalluar për çështjen kombëtare, Bacës, Adem Demaçi!

30 korrik 2018, Dr. Haxhi Ibishi, Binak Sylja, Klinë

Respekt për jetë e mote!... Skënderbeu i Kosovës!

30 korrik 2018, Milazim Rekalju

Me respekt të veçantë Bacës Adem Demaçi!

30 korrik 2018, Ahmet Jahiri

Nderime vizionarit të kombit!

30 korrik 2018, Sh. Hasimja

Shkoi në amshim heroi ynë, Baca Adem, shoku e miku ynë i madh, luftëtari i panënshtruar në luftë për liri të shqiptarëve!

30 korrik 2018, pensioneri, Sh. Sheqiri

Erdha me pa për heroin kombëtar! Erdha ta nderoj veprën e Atij, që sakrifikoi çdo gjë për liri. Vepra jote, Bacë, do të na shoqërojë sa të jemi gjallë!

30 korrik 2018, (nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem, erdhëm për ty, erdhëm edhe tash kur u ndave nga ne, por do jetosh në mendjet tona përherë!

30 korrik 2018, Bajram Podvorica, Nur Bushi

I madh ishe dhe të mbetesh i madh, o Baca Adem!

30 korrik 2018, (nënshkrimi i palexueshëm)

Adem Demaçi, ti je vet historia e kombit tonë shqiptar! Respekt!

30 korrik 2018, R. (mbiemri i palexueshëm)

Me nderime, SHFO dhe SHIL - UÇK-së! Lavdi veprës dhe jetës së të pavdekshmit, nderit të kombit, Adem Demaçi!

30 korrik 2018, (nënshkrimi i palexueshëm)

SHFD, ngushëllime të sinqerta për patriotin e kombit, vizionarin e shtetit të Kosovës, bacën Adem Demaçi!

30 korrik 2018, (nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem, Ti ishe simbol i çështjes kombëtare. Të na solle lirinë në Kosovë! Ti s'ke vdekur, por do të mbetesh i gjallë sa të jetoj kombi shqiptar!

30 korrik 2018, prof. Idriz Gashi, Llap

Me nderimet më të larta, shprehim ngushëllimet Familjes së Bacës, Adem Demaçit. Baca Adem, ti ishe vlera më e madhe e kombit shqiptar, ti ishe simbol i



bashkimit të trojeve shqiptare. Prehu në paqen meritore, Bacë!

30 korrik 2018, Nazmi Canolli

Bacë, ata që deshën me të pa të vdekur nuk u erdhën me të pa as për së vdekuri. Pusho i qetë! I lehtë të qoftë dheu i Kosovës!


30 korrik 2018, (nënshkrimi i palexueshëm)

Fli i qetë o Baca Adem, o gurthemeli i Kosovës e i gjithë Shqipërisë! Zoti ta pagoftë mundin e historia ta vlerësoftë me meritë veprën Tënde! Të nderon përherë, shoku yt, Bacë!

30 korrik 2018, Aziz Latifi, Koliq

